

Deri te:

**KËSHILLI MËSIMOR SHKENCOR I  
FAKULTETIT PEDAGOGJIK, NË  
UNIVERSITETIN E TETOVËS**

Në bazë të neneve 110 dhe 173 të Ligjit për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018, nenit 158 të Statutit të Universitetit të Tetovës dhe në përputhje me Rregulloren dhe kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimoro-profesional dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës, në lidhje me konkursin për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Universitetin e Tetovës të shpallur më 24.06.2025 në gazetata ditore “Koha” dhe “Sloboden Peçat” si dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, për zgjedhjen e një mësimdhënësi në lëmin *Metodikë* (5.03.00.03) dhe *Didaktikë* (5.03.00.02) nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencor-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Pedagogjik në mbledhjen e mbajtur më 09.07.2025 solli vendim për formimin e Komisionit recensues me nr. 24-852/1, në përbërje:

1. Prof.dr.Avzi Mustafa (kryetar) - profesor ordinar në pension,
2. Prof.dr.Lulzim Mehmedi (anëtar) - profesor inordinar në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës,
3. Prof.dr.Svetlana Pandiloska-Gërçarovska (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Pedagogjik të Universitetit të Tetovës.

Duke falënderuar për besimin e dhënë, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, Komisioni recensues ka nderin të paraqesë këtë:

**R E F E R A T**

**PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE SHKENCORE NË LËMIN METODIKA (5.03.00.03) DHE DIDAKTIKA (5.03.00.12) NGA KLASIFIKIMI I SFERAVE, FUSHAVE DHE LËMENJVE SHKENCORË-HULUMTUES SIPAS KLASIFIKIMIT NDËRKOMBËTAR TË FRASKATIT NË FAKULTETIN PEDAGOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS.**

Në konkursin e shpallur në gazetata ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“ të datës 24.06.2025 si dhe në ueb-faqen e Universitetit [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), për zgjedhje/rizgjedhje

të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin *Metodikë* (5.03.00.03) dhe *Didaktikë* (5.03.00.02) nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), është paraqitur vetëm kandidatja **doc.dr.Arbresha Zenki-Dalipi**. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe të dhënave të tjera të kandidatit, Komisioni recensues jep këto konstatime dhe vlerësime:

### **1. Të dhënat biografike të kandidatit**

Kandidatja dr.Arbresha Zenki-Dalipi lindi më 1 janar 1975, në Gostivar. Shkollimin fillor e kreu në Gostivar në vitin 1990, ndërsa arsimin e mesëm e kreu në vitin 1994 në shkollën e mesme “Pançe Popovski”- Gostivar. Në vitin 1995 kryen provimet e shkollës së mesme të mjekësisë në shkollën “Dr.Ali Sokoli”-Prishtinë, Republika e Kosovës, ku kurorëzohet me diplomën e dytë për shkollë të mesme, përkatësisht emërtohet teknike laborante e diplomuar e mjekësisë.

Arsimin e lartë kandidatja Arbresha Zenki-Dalipi e mori në Fakultetin Pedagogjik “Shën. Kliment Ohridski ”në Universitetin“Shën. Kiril dhe Metodi” - Shkup në 2001, kur edhe e njejta u punësua si mësuese e grupit klasor në shkollë fillore.

Zhvillimi profesional dhe kontributi i saj në fushën e pedagogjisë, didaktikës e metodikës lejoi vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë në fushën e pedagogjisë-sfera arsimore. E udhëhequr nga mentori prof. dr. Avzi Mustafa, kandidatja më 2013 mbrojti temën e magjistraturës “Zbatimi i strategjive të të kuptuarit e leximit në ciklin e parë zhvillimor të shkollave fillore në Gostivar “ me çrast u emërtua Magjistër i shkencave të Pedagogjisë, Drejtimi Arsimor.

Në vitin akademik 2015/2016 kandidatja ka regjistruar studimet e ciklit të tretë të shkollës së doktoratës në Universitetin “Shën Kiril dhe Metodij” - Shkup. Nën mentorim të prof. dr. Jasmina Dellçeva – Dizdareviq në vitin 2019 mbrojti temën e doktoraturës “*Vlerësimi i efikasitetit të vizualizimit në procesin e shkrim-leximit*” kur edhe u kurorëzua me titullin Doktor i shkencave të Pedagogjisë.

Kandidatja zotëron gjuhën maqedonase, angleze (me certifikatë B2), si dhe gjuhën serbe dhe turke. Bazuar nga të dhënat e ofruara nga kandidatja përmes aplikimit në konkurs, komisioni ka marrë parasysh veprimtarinë e saj të përgjithshme, duke veçuar dhe vlerësuar kontributin pas emërimit në thirrjen *docent* deri sot.

## **ARRITJET SHKENCORE, PROFESIONALE, PEDAGOGJIKE DHE TË TJERA TË KANDIDATES NGA ZGJEDHJA E FUNDIT DERI NË DITËN E APLIKIMIT**

### **1. Veprimtaria edukative-arsimore:**

Doc. dr. Arbresha Zenki-Dalipi, pas emërimit në thirrjen *docent* më 25.12.2020, është angazhuar në mbajtjen e ligjëratave, ushtrimeve dhe orëve praktike në ciklin e parë dhe dytë të studimeve. Në cikin e parë të studimeve Zenki-Dalipi u angazhua në lëndët: Didaktika e mësimdhënies së gjuhës amtare I me praktikë pedagogjike, Didaktika e mësimdhënies së gjuhës amtare II me praktikë pedagogjike, Didaktika e mësimdhënies së gjuhës amtare III me praktikë pedagogjike, Pedagogjia sportive, Pedagogjia, Didaktika e mësimit të DNSH-së I me praktikë pedagogjike, Didaktika e mësimit të DNSH-së II me praktikë pedagogjike, Metodika e gjuhës dhe letërsisë shqipe, Metodika e mësimdhënies së gjuhës dhe shkrim leximit fillestar, Metodika e mësimdhënies së fushës natyrore-shkencore dhe shoqërore I, Metodika e mësimdhënies së fushës natyrore-shkencore dhe shoqërore II, Metodika e mësimdhënies së letërsisë dhe Praktika Pedagogjike dhe Praktika dhe Stazhi pedagogjik.

Në cikin e dytë të studimeve ka qenë e angazhuar në lëndët: Teoria dhe praktika e kurrikulës, Metodologjia e hulumtimit shkencor, Praktikumi metodik, Dekiluenca e të miturve dhe Metodika e shkrim-leximit fillestar.

Doc.dr.Arbresha Zenki-Dalipi ka qenë e kyçur në aktivitete të shumta me qëllim të zhvillimit të kompetencave të mësimdhënësve përmes trajnimeve të organizuara në kuadër të projekteve për zhvillim profesional të mësimdhënësve të shkollave fillore në RMV.

### **1.1.Trajnime:**

- Trajnuese e programeve “Planifikimi dhe zbatimi i mësimdhënies sipas konceptonit të ri për arsimin fillor”nga BZHA, 2021,
- Trajnimet e ciklit të parë të organizuara në korniza të realizimit të programeve të akredituara nga BZHA, 2022, *Edukimi në një kontekst bashkëkohor: Zhvillimi i shkathtësive socio-emocionale;*
- Trajnimet e ciklit të dytë të organizuara në korniza të realizimit të programeve të akredituara nga BZHA, 2023, *Edukimi në një kontekst bashkëkohor: Zhvillimi i shkathtësive socio-emocionale;*
- Trajnimet e ciklit të tretë të organizuara në korniza të realizimit të programeve të akredituara nga BZHA, 2024, *Edukimi në një kontekst bashkëkohor: Zhvillimi i shkathtësive socio-emocionale.*

### **1.2.Anëtare e grupit punues për hartim të programeve,** edhe atë:

- Programi mësimor, GJUHË SHQIPE për klasën I;
- Programi mësimor, GJUHË SHQIPE për klasën II;
- Programi mësimor, GJUHË SHQIPE për klasën III;
- Programi mësimor, GJUHË SHQIPE për klasën IV dhe
- Programi mësimor, GJUHË SHQIPE për klasën V.

### **1.3.Grupin konsultues për përgatitje të:**

- Ligjit për Tekstet Shkollore për Arsimin Fillor dhe të Mesëm gjatë vitit 2023.
- Ligjit për Tekstet Shkollore për Arsimin Fillor dhe të Mesëm gjatë vitit 2024.
- Grupit Punues Konsultativ për Shqyrtimin e Draft Programit Studimor për Arsimin Fillestar më 2024.

### **1.4.Realizues i punëtorive:**

- “Социјално и емоционално учење во раното детство”, (maj- qershor 2022), Universiteti Kiril dhe Metodij, Shkup;
- “Aspektet specifike të komunikimit me nxënësit”- Java e veçantë studimore, hulumtuese dhe shkencore 2022;

- “Kreativiteti në mësimdhënien e lëndës së gjuhës amtare” - Java e veçantë studimore, hulumtuese dhe shkencore 2024,
- “Të mësuarit aktiv përmes lojës: Promovimi i të mësuarit socio-emocional ” - Java e veçantë studimore, hulumtuese dhe shkencore 2024,
- “Roli i lojës në zhvillimin socio-emocional Metoda dhe praktika pedagogjike” - Konferenca IV Ndërkombëtare e Fakultetit Pedagogjik më vitin 2024.

### **1.5.Udhëheqëse e programit studimor në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve / anëtare e komisionit për vlerësim të punimeve të diplomës apo tezës së magjistraturës.**

Gjatë angazhimit të saj pedagogjik, kandidatja zhvilloi bashkëpunim të ngushtë me studentët, duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave të tyre profesionale. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, që nga zgjedhja e saj e fundit deri sot, doc.dr. Arbresha Zenki-Dalipi **ka mentoruar:**

- 30 studentë dhe ka qenë anëtare në 37 komisione të mbrojtjes së temave të diplomës;
- 18 mbrojtje të temave të masterit (9 mbrojtje prej të cilave si mentore e kandidatëve). Aktualisht është duke mentoruar 3 studentë të ciklit të dytë.

### **1.6.Kandidatja është autore e dy librave universitarë të recenzuar:**

- *Zbatimi i strategjive të të kuptuarit e leximit në ciklin e parë zhvillimor*, (2022), Tetovë:Luma Graphic, ISBN 978-608-66914-0-0;
- *Metodika e mësimit bashkëkohor të shkrim-leximit fillestar në ciklin e parë zhvillimor II*, (2022), Tetovë: UT, ISBN 978-608-217-114-2.

### **1.7.Bashkëautore e një doracaku:**

- *Të mësuarit socio-emocional në fëmijërinë e hershme*, (2022), Shkup: Universiteti Kiril dhe Metodij, ISBN 978-608-238-214-2

### 1.8. Përgatitja e dispencave për përdorim të brendshëm nga ligjeratat, edhe atë:

- “Didaktika e mësimit të gjuhës amtare I me praktikë pedagogjike”;
- “Didaktika e mësimit të gjuhës amtare II me praktikë pedagogjike”;
- “Didaktika e mësimit të DNSH-së II me praktikë pedagogjike”;
- “Metodika e mësimit të gjuhës dhe shkrim - leximit fillestar”;
- “Metodika e letërsisë”;
- “Metodika e gjuhës dhe letërsisë shqipe”.

### 1.9. Recensuese e librave:

- Xheladin Murati, *Libri shkollor, digjitalizimi i tij dhe ndryshimet në arsim*, (2022), Tetovë: Luma Grafik, ISBN: 978-608-4971-10-8;
- Ardita Ceka, *Pedagogy of Family*, student handbook, Amazon, ISBN: 979-8302202802.

### 1.10. Anëtar i Komisionit për organizimin e manifestimit të:

- *I Qershori-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve*, Vendim 24-459/1 Data 18.05.2023

### 1.11. Organizim i Shkolla Verore: “Социјално и емоционално учење во раното детство”, (Qershor 2022), Universiteti Kiril dhe Metodij, Shkup

Në bazë të Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësuesorë-shkencorë, shkencorë, mësuesorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. . 01-4309/2 e datës 01.12.2021, kandidatja **Arbresha Zenki-Dalipi** ka realizuar gjithsej **135.378** pikë nga **veprimtaria edukative-arsimore**.

## 2. Veprimtaria kërkimore - shkencore

Opusi i begatë shkencorë – hulumtues i kandidatës Arbresha Zenki – Dalipi nga zgjedhja e fundit në titull në vitin 2020 fokusohet kryesisht në metodikë. Krahas çështjeve tjera

pedagogjike si vlerësimi, interkulturaliteti dhe zhvillimi socio-emocional, pjesa dërmuese e veprimtarisë shkencor-hulumtuese ku Zenki-Dalipi është autore e parë apo e vetme, shqyrton shkrim-leximin fillestar, si dhe faktorë që ndikojnë në përvetësim efikas dhe zhvillim të aftësisë së të kuptuarit e leximit, fushë e cila është interes i theksuar i kandidatës. Punime të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare dhe veprimtari tjera të prezentuara në konferenca me karakter ndërkombëtar janë si vijojnë:

### 2.1. Punime shkencore:

1. Zenki-Dalipi, Arbresha, (2021), Inclusion of contemporary reading comprehension approaches into the first cycle developmental curriculum, Knowledge International Journal, Vol: 45.2, ISSN 2545-4439 (print) ISSN 1857-923X (online), p. 355-361.
2. Agai, Arita, & Zenki-Dalipi, Arbresha, (2022), Impact of communication difficulties on students' success, Knowledge International Journal, Vol: 53.2, 2022, ISSN: 1857- 923X (Printed), ISSN: 2545-4439 (Online) [https://openurl.ebsco.com/EPDB%3Aagd%3A8%3A13633272/detailv2?sid=ebsco%3Aplink%3Ascholar&id=ebsco%3Aagd%3A159283012&url=c&link\\_origin=scholar.google.com](https://openurl.ebsco.com/EPDB%3Aagd%3A8%3A13633272/detailv2?sid=ebsco%3Aplink%3Ascholar&id=ebsco%3Aagd%3A159283012&url=c&link_origin=scholar.google.com).
3. Zenki-Dalipi, Arbresha & Osmani, Rabije, (2022), The positive influence of images and graphics presentations in teaching texts for keeping students' attention and concentration, Knowledge International Journal, 54 (5), <https://doi.org/10.35120/kij5405751z>, ISSN: 1857-923X (Printed), ISSN: 2545-4439 (Online), p. 751–756 <https://scispace.com/pdf/the-positive-influence-of-images-and-graphics-presentations-29merejc.pdf>.
4. Zenki-Dalipi, Arbresha, Dogani, Besa & Ameti, Makfirete, (2022), Assessment Of Student Achievements During The Covid Pandemic, Journal of Educational Research Faculty of Pedagogy of the University of Tetova, Vol:3/NO.5-6,

- UDC:37.011.3-051: [37.018.43:004: {616.98:578.834(497.7), 2022, ISSN: 2671 – 3268 (Print), ISSN: 2671 – 3276 (Online).
5. Xhambazi, Gzim, Ceka, Ardita & Zenki-Dalipi, Arbresha, (2022), Students Preference For Printed Reading Books And Digital Books: They Prefer Reading From Printed Books, Whereas They Read In Digital Form, Journal Of Educational Research Faculty Of Pedagogy Of The University Of Tetova, Vol.4 / No.5-6, ISSN: 2671 – 3268 (Print), ISSN: 2671 – 3276 (Online).
  6. Dogani, Besa, Zenki-Dalipi, Arbresha, Xhelili, Arta & Xhelili, Nida, (2023), Interaction In Distance Learning, Journal Of Educational Research Faculty Of Pedagogy Of The University Of Tetova, Vol.4 / No.7-8, ISSN: 2671 – 3268 (Print), ISSN: 2671 – 3276 (Online).
  7. Zenki-Dalipi, Arbresha, (2023), Teacher's Information And Competencies In The Application Of Visualization In The Teaching Process, 12th International Istanbul Scientific Research Congress on Humanities And Social Sciences Proceeding Books, ISBN: 978-975-00544-1-9, p.672-677.
  8. Zenki-Dalipi, Arbresha, (2023), Visualization in Natural Sciences, 8th International "Başkent" Congress On Humanities And Social Sciences, Turkey, 04.02.2023, ISBN 978-975-00544-3-3, p 779-783.
  9. Zenki-Dalipi, Arbresha, (2023), Characteristics Of Visualization In Literacy: Meaning And Importance, International Journal of Albanology. Albanologjia, Vol:10, No.19-20, ISSN: 1857-9485 (Print), ISSN: 2545-4919 (Online), p.78-83. <http://eprints.unite.edu.mk/id/eprint/1238>.
  10. Adili, Bujar, Zenki-Dalipi, Arbresha & Ameti, Makfirete, (2023), An Investigation into Teachers' Attitudes to Religious Education in North Macedonia Primary Schools, Dinamika Ilmu, Vol: 23(2), 291-302. P-ISSN: 1411-3031; E-ISSN: 2442-9651 <https://doi.org/10.21093/di.v23i2.7302>.



11. Adili, Bujar, Zenki-Dalipi, Arbresha & Ameti, Makfirete, (2023), Teachers' Attitudes Towards Desirable Intercultural Competences Necessary for Working in Multicultural Classrooms, *Journal of Educational Technology and Instruction*, Vol:2(2), 32-46. e-ISSN: 2963-458X <https://doi.org/10.70290/jeti.v2i2.74> .
12. Adili, Bujar, Zenki-Dalipi, Arbresha& Ameti, Makfirete, (2024), Exploring Intercultural Communication Competence Among Primary School Teachers In North Macedonia: A Survey Analysis, *Journal of Positive Psychology and Wellbeing*, Vol: 8(2), 151 162. ISSN: 2587-0130 (Online) <https://journalppw.com/index.php/jppw/article/view/18400>.
13. Zenki-Dalipi, Arbresha & Rushidi-Rexhepi, Jehona, (2024), Një analizë teorike dhe qasje përshkruese e tekstit universitar “Didaktika e gjuhës shqipe dhe leximit letrar” të prof. Avzi Mustafës, *Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore E Kulture Të Shqiptarëve – Shkup*.
14. Zenki-Dalipi, Arbresha, Xhambazi, Gzim & Ceka, Ardita, (2024), Socio-Emotional Learners – The Importance Of Teacher Competence Development, *Education*, Vol: 6 | No. 11-12., UDC: 159.922:[37.011.3-051-057.875:005(497.7)] <https://doi.org/10.62792/ut.education.v6.i11-12.p2655>.
15. Abdija, Narta & Zenki-Dalipi, Arbresha, (2024), Application of the Portfolio as A Method of Assessment and Development of Students' Achievements, *Education*, Vol. 6 | No. 11-12., UDC: 373.3.091.279.7 <https://doi.org/10.62792/ut.education.v6.i11-12.p2634> .
16. ZENKI-DALIPI, Arbresha (2024) STRATEGJITË EFEKTIVE TË TË KUPTUARIT E LEXIMIT FILLESTAR. *ALBANOLOGJIA International Journal of Albanology*, 11 (21-22). pp. 36-43. ISSN (Print): 1857-9485 ISSN (Online): 2545-4919 <http://eprints.unite.edu.mk/id/eprint/1869> .
17. Zenki-Dalipi, Arbresha, (2024), Global Reading – (Non) Conventional Model Of Reading, *Filologjia*, Vol. 12 | No. 22-23, UDC: 028.1:811.18]:373.3.091.3(047.31) <https://openurl.ebsco.com/EPDB%3Agcd%3A4%3A13668420/detailv2?sid=ebsc>

[o%3Aplink%3Ascholar&id=ebsco%3Agcd%3A180180466&crl=c&link\\_origin=scholar.google.com](https://scholar.google.com/o%3Aplink%3Ascholar&id=ebsco%3Agcd%3A180180466&crl=c&link_origin=scholar.google.com) .

18. Journal of Educational Technology and Instruction, Vol: 24(2), 275-289. P-ISSN: 1411-3031; E-ISSN: 2442-9651 <https://doi.org/10.21093/di.v24i2.9284>.
19. Adili, Bujar, Zenki-Dalipi, Arbresha & Ameti, Makfirete, (2024), Examining the Impact of Intercultural Education on the Levels of Intercultural Sensitivity of Primary School Teachers: Evidence From North Macedonia, *Pedagogika*, Vol: 155, No.3, <https://doi.org/10.15823/p.2024.155.3>, ISSN 1392-0340 (Print), ISSN 2029-0551 (Online).
20. Rushidi-Rexhepi, J., & Zenki-Dalipi, Arbresha., (2025), Rikrijimet në letërsinë shqiptare për fëmijë si gërshetim i teknikave intertekstuale dhe përshtatjes ndaj kërkesave pedagogjike, *Languages, Cultures, and Communication: The future of the humanities and Social Science*, April, 2025, Online: <https://conf.seeu.edu.mk/archive/>, ISSN: 2955-263X.

## 2.2.Pjesëmarrje në konferenca

1. **Zenki-Dalipi, Arbresha**, *Karakteristikat e vizualizimit në shkrim-leximin fillestar: Kuptimi dhe Rëndësia*, Seminari XVI Albanologjik, (28-29 shtator 2022), UT, Tetovë.
2. **Zenki-Dalipi, Arbresha**, 3th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy, (16-18 Nëntor 2022), UT, Tetovë.
3. **Zenki-Dalipi, Arbresha**, (2023), *Teacher's information and competencies in the application of visualization in the teaching process*, 12th International Istanbul Scientific Research Congress on Humanities And Social Sciences Proceeding Books on January 21-23, 2023 Istanbul, Turkey.
4. **Zenki-Dalipi, Arbresha**, (2023), *Visualization in Natural Sciences*, 8th International "Başkent" Congress On Humanities And Social Sciences, 04.02.2023, (Pp 779-783), Isbn 978-975-00544-3-3, Turkey.

5. **Zenki-Dalipi, Arbresha,** (2023), *Karakteristikat e vizuelizimit në shkrim-leximin fillestar: kuptimi dhe rëndësia*, Seminari XVII Ndërkombëtar i Albanologjisë, Letërsia në Kontekstin Evropian.
6. **Zenki-Dalipi, Arbresha,** Tairi, Leonora & Agai, Arita, (2022), *Bashkëpunimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta*, Journal of Educational Research Faculty of Pedagogy of the University of Tetova, Vol.4 / No.5-6.
7. Ceka, A., Xhambazi, G., & **Zenki-Dalipi, Arbresha.**, (2023), *The Intersection of Family Dynamics and Educational Styles: Impact on Children's Development*, 2nd International Conference on Recent Academic Studies ICRAS 2023, ISBN: 978-625-6530-67-6, ISBN 978-625-6530-67-6 Printed in Turkey with ISBN 978-625-6530-67-6, <https://as-proceeding.com/index.php/icras/home>, October, 2023.
8. **Zenki-Dalipi, Arbresha,** (2023), *Global Reading – (Non) Conventional Model Of Reading*, 8th International Scientific Conference of the Faculty of Philology ISCFP 2023, University of Tetova, 15-17 November 2023.
9. Abdija, N., & **Zenki-Dalipi, Arbresha.**, (2023), *Application Of The Portfolio As A Method Of Assessment And Development Of Students' Achievements*, 4th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy ISCFPE 23, University of Tetova, 15-17 November 2023.
10. **Zenki-Dalipi, Arbresha.**, Ilazi-Hoxha, A., & Osmani, R., (2023), *Development Of Socio-Emotional Skills - Knowledge, Perceptions And Practices*, 4th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy ISCFPE 23, University of Tetova, 15-17 November 2023.
11. **Zenki-Dalipi, Arbresha,** Xhambazi, G., & Ceka, A., *Socio-Emotional Learners – The Importance Of Teacher Competence Development*, 4th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy ISCFPE 23, University of Tetova, 15-17 November 2023.
12. Osmani, R., **Zenki-Dalipi, Arbresha.**, (2023), *Compatibility Of Natural Science Books With The Curriculum In The First Developmental Cycle*, 4th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy ISCFPE 23, University of Tetova, 15-17 November 2023.

13. **Zenki-Dalipi, Arbresha, & Rushidi - Rexhepi, J.**, (2024), Një analizë teorike dhe qasje përshkruese e tekstit universitar “*Didaktika e gjuhës shqipe dhe leximit letrar*” të prof. Avzi Mustafës, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore E Kulturore Të Shqiptarëve – Shkup.
14. Rushidi-Rexhepi,J., & **Zenki-Dalipi, Arbresha.**,(2023), *Rikrijimet në letërsinë shqiptare për fëmijë si gërshetim i teknikave intertekstuale dhe përshtatjes ndaj kërkesave pedagogjike*, International Conference of FLCC, Languages, Cultures, and Communication: The future of the humanities and Social Science, May,2024.
15. **Zenki-Dalipi, Arbresha.**, Rushidi-Rexhepi, J., & Osmani, R., (2024), *Visual Text Alignment and Its Impact on Reading Comprehension A Study of Congruent and Incongruent Imagery*, 5th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy, Sustainable Education For A Sustainable Society -*ISCFPE24*, 06-08, November 2024.

### **2.3.Abstrakte të publikuara (veçmas nga publikimet)**

1. **Zenki-Dalipi, Arbresha**, Tairi,Leonora & Agai, Arita, (2022), *Bashkëpunimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta*, Journal of Educational Research Faculty of Pedagogy of the University of Tetova, Vol.4 / No.5-6.
2. Ceka, A., Xhambazi, G., & **Zenki-Dalipi, Arbresha.**, (2023), *The Intersection of Family Dynamics and Educational Styles: Impact on Children's Development*, 2nd International Conference on Recent Academic Studies ICRAS 2023, ISBN: 978-625-6530-67-6, ISBN 978-625-6530-67-6 Printed in Turkey with ISBN 978-625-6530-67-6, <https://as-proceeding.com/index.php/icras/home>, October,2023.
3. **Zenki-Dalipi, Arbresha.**, Ilazi-Hoxha, A., & Osmani, R., (2023), *Development Of Socio-Emotional Skills - Knowledge, Perceptions And Practices*, 4th International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy ISCFPE 23, University of Tetova, 15-17 November 2023.

#### 2.4.Prezantim me ftesë të universitetit referues:

- “*The Importance of Socio-Emotional Development in the Primary Cycle*” - Vizita studimore në University of Northern Illinois, Ilionois, SHBA

Në përputhje me Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë-profesionalë dhe bashkëpunëtorë të Universitetit të Tetovës nr. . 01-4309/2 e datës 01.12.2021, kandidatja doc.dr. Arbresha Zenki-Dalipi ka realizuar gjithsejt **149.079** pikë nga veprimtaria kërkimore-shkencore.

### 3. Veprimtaria profesionale-zbatuese

#### 3.1. Autore libri:

- **Arbresha Zenki-Dalipi**, *Zbatimi i strategjive të të kuptuarit e leximit në ciklin e parë zhvillimor*, (2022), ISBN: 978-608-66914-0-0, Tetovë: Luma Graphic;
- **Arbresha Zenki-Dalipi & Makfirete Ameti**, *Metodika e mësimit bashkëkohor të shkrim-leximit fillestar në ciklin e parë zhvillimor II*, (2022), ISBN: 978-608-217-114-2, Tetovë: Universiteti i Tetovës.

#### 3.2. Koautore e doracakut:

- **Arbresha Zenki-Dalipi**, Anna Fritschand, Elizabeta Tomevska Ilievska, Lena Damovska, Kiril Barbareev, Natasha Stanojkovska Trajkovska, Tatjana Koteva Mojsovska, Florina Shehu, Maja Raunik Kirkov, Tatjana Atanasoska, *Të mësuarit socio-emocional në fëmijërinë e hershme*, (2022), ISBN: 978-608-238-214-2, Shkup:UKIM.

#### 3.3. Recensuese libri:

- Xheladin Murati, “*Libri shkollor, digjitalizimi i tij dhe ndryshimet në arsim*”, (2022), Tetovë: Luma Grafik, ISBN: 978-608-4971-10-8;

- Ardita Ceka, *Pedagogy of Family*, student handbook, Amazon, ISBN: 979-8302202802.

#### **3.4. Anëtare e grupit punues për:**

- Përgatitja e *Elaborateve të programeve studimore të ciklit të tretë* në Fakultetin Pedagogjik, Vendim nr. 24-794/1 Data 22.09.2022.
- Koordinator i Komisionit për përgatitjen e *Elaborateve të programeve studimore të ciklit të parë* në Fakultetin Pedagogjik, Vendim nr. 24-417/1 Data 15.04.2025.

#### **3.5. Aktivitetet për promovim të Fakultetit, përkatësisht promovim të Universitetit:**

- Ditët e hapura 2021;
- Ditët e hapura 2023;
- Ditët e hapura 2024.

#### **3.6. Angazhime si eksperte:**

- *Programi mësimor, Gjuhë Shqipe për klasën I*, Vendim nr. 03-12/09, Data 26.03.2025.
- *Programi mësimor, Gjuhë Shqipe për klasën II*, Vendim nr. 03-12/10, Data 26.03.2025.
- *Programi mësimor, Gjuhë Shqipe për klasën III*, Vendim nr. 03-12/11, Data 26.03.2025.
- *Programi mësimor, Gjuhë Shqipe për klasën IV*, Vendim nr. 03-12/12, Data 26.03.2025.
- *Programi mësimor, Gjuhë Shqipe për klasën V*, Vendim nr.03-12/13, Data 26.03.2025.
- *Përgatitja e Ligjit për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm*, Vendim 08-2321/2 Data 23.02.2023.
- *Përgatitja e Ligjit për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm*, Vendim 13-6257/1 Data 08.06.2024.

- *Grupi Punues Konsultativ për Shqyrtimin e Draft Programit Studimor për Arsimin Fillestar, Vendim 10-8279/1 Data 19.02.2024.*

### **3.7.Pjesëmarrje aktive dhe kontribut në Javën e veçantë studimore, hulumtuese dhe shkencore**

- Java e veçantë studimore, hulumtuese dhe shkencore, viti 2022;
- Java e veçantë studimore, hulumtuese dhe shkencore, viti 2023;
- Java e veçantë studimore, hulumtuese dhe shkencore, 2024.

### **3.8.Referat në manifestimin qendror të Universitetit të Tetovës**, organizuar nga Fakulteti Pedagogjik, 07.03.2023.

## **4. Veprimtaria me interes më të gjërë**

### **4.1.Anëtare e këshillit redaktues të revistës shkencore/profesionale ndërkombëtare:**

- Anëtare e këshillit redaktues të revistës shkencore/profesionale ndërkombëtare *Education & Youth Research*, 2021v.-deri sot.

### **4.2.Anëtare e këshillit redaktues të revistës shkencore/profesionale ndërkombëtare:**

- Anëtare e komisionit organizues ose programor të manifestimit shkencore/profesionale ndërkombëtare *Konferenca e Tretë Ndërkombëtare e Fakultetit Pedagogjik, 16-18 nëntor 2022;*
- Anëtar i këshillit organizues të tubimit shkencor/profesional ndërkombëtar: *Konferenca e Katërt Ndërkombëtare e Fakultetit Pedagogjik, 15-17 nëntor 2023;*
- Anëtar i këshillit organizues të tubimit shkencor/profesional ndërkombëtar: *Konferenca e Pestë Ndërkombëtare e Fakultetit Pedagogjik, 6-8 nëntor 2024.*

#### **4.3. Anëtare e komisioneve të fakultetit:**

- Ushtrues detyre - Dekan i Fakultetit Pedagogjik, Vendim nr. 02-1075/1 Data 31.03.2022.
- Koordinatore e programit studimor Edukim parashkollor, Vendim nr. 24-909/1 Data 04.10.2021.
- Koordinatore e programit studimor Mësimi klasor, Vendim nr. 24-513/1 Data 10.06.2022.
- Koordinatore e programës Arsimit Elementar – cikli i dytë i studimeve.
- Anëtar i Senatit të Universitetit të Tetovës viti 2022-2024.
- Anëtar i Senatit të Universitetit të Tetovës viti 2024-deri më sot.
- Anëtar i Komisionit për përgatitjen e Raportit Vjetor për vitin akademik 2020/2021, Vendim nr. 24-1306/1 Data 13.12.2021.
- Anëtar në përgatitjen e Elaborateve të programeve studimore të ciklit të tretë në Fakultetin Pedagogjik, Vendim nr. 24-794/1 Data 22.09.2022.
- Koordinator i Komisionit për përgatitjen e Elaborateve të programeve studimore të ciklit të parë në Fakultetin Pedagogjik, Vendim nr. 24-417/1 Data 15.04.2025.
- Anëtar i Komisionit për provim pranues të studentëve të ciklit të parë në vitin akademik 2022/2023, Vendim nr. 24-681/1 Data 01.09.2022.
- Anëtar i komisionit për vërtetimin e realizimit të mësimi praktik në sem. V, VI, VII dhe VIII në vitin akademik 2020/2021 në programet Mësim Klasor dhe Drejtim Parashkollor, Vendim nr. 24-490/1 Data 02.06.2022.
- Anëtare e komisionit për realizimin e provimit në lëndët: Didaktika e fushës natyrore-shkencore me praktikë pedagogjike, Vendim 24-60/3 Data 01.02.2022.
- Anëtare e komisionit për realizimin e provimit në lëndët: Didaktika e mësimdhënies së DNSH-së me praktikë pedagogjike, Vendim 24-57/1 Data 01.02.2022.
- Anëtare e komisionit për realizimin e provimit në lëndët: Fëmija hulumtues I, Vendim 24-58/3 Data 01.02.2022.
- Anëtare e komisionit për realizimin e provimit në lëndët: Zhvillimi i marrëdhënieve mes gjinive, Vendim 24-58/1 Data 01.02.2022.



- Anëtare e komisionit për realizimin e provimit në lëndët: Ndjekja e përparimit të fëmijëve, Vendim 24-58/2 Data 01.02.2022.
- Anëtar i Komisionit zgjedhor të Fakultetit Pedagogjik për realizim të procedurës për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës për periudhën 2023-2026, Vendim 24-457/1 Data 18.05.2023.
- Anëtar i Komisionit për organizimin e manifestimit të 1 Qershori-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Vendim 24-459/1 Data 18.05.2023.
- Anëtar i Komisionit për provim pranues të studentëve të ciklit të parë në vitin akademik 2023/2024, Vendim 24-668/1 Data 12.07.2023.
- Anëtare e komisionit për realizimin e provimit në lëndët: Didaktika e mësimdhënies së matematikës 2 me praktikë pedagogjike, Vendim 24-702/2 Data 18.07.2023
- Anëtar i Komisionit për përgatitjen e Program vjetor për vitin akademik 2023/2024, Vendim 24-384/1 Data 28.09.2023.
- Anëtar i Komisionit për regjistrimin e kandidatëve për përgatitjen pedagogjiko-psikologjike dhe metodike në Fakultetin Pedagogjik, Vendim 24-45/1 Data 08.02.2024.
- Anëtar i Komisionit për regjistrimin e semestrit me vonesë jashtë afatit për regjistrimin në programet studimore të ciklit të parë në Fakultetin Pedagogjik, Vendim 24-299/1 Data 26.03.2024.
- Anëtar i Komisionit për përgatitjen e Program vjetor për vitin akademik 2024/2025, Vendim 24-1124/1 Data 05.11.2024.
- Kryetar i Komisionit zgjedhor për zbatimin e procedurës për zgjedhjen e dekanit të Fakultetit Pedagogjik, Vendim 24-70/1 Data 03.02.2025.
- Kryetar i Komisionit zgjedhor për zbatimin e procedurës për zgjedhjen e prodekanëve të Fakultetit Pedagogjik, Vendim 24-190/1 Data 24.02.2025.
- Koordinator i Komisionit për përgatitjen e Elaborateve të programeve studimore të ciklit të parë në Fakultetin Pedagogjik, Vendim nr. 24-417/1 Data 15.04.2025.

Në përputhje me Rregulloren për Kushtet e Veçanta dhe Procedurën e Përzgjedhjes për Tituj Mësimorë-Shkencorë, Shkencorë, Mësimorë-Profesionalë, Shkencorë dhe të Bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr.01-4309/2 e datës 01.12.2021, kandidatja

doc.dr. Arbresha Zenki-Dalipi nga fusha **profesionale-aplikative** dhe **veprimtaritë me interes më të gjerë** ka marrë gjithsej **69** pikë, që tejkalon ndjeshëm numrin minimal të pikëve të kërkuara për përzgjedhje në thirrje të profesorit inordinar.

## PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Bazuar nga dokumentacioni i përgjithshëm dhe njohjen personale të kandidatës, Komisioni recensues e vlerëson pozitivisht veprimtarinë mësimore shkencore, veprimtarinë kërkimore shkencore, veprimtarinë aplikative-profesionale si dhe veprimtarinë me interes të gjerë shoqëror të doc. dr. Arbresha Zenki-Dalipi.

Komisioni vlerëson se doc. dr. Arbresha Zenki-Dalipi i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Rregulloren për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimoro-profesional dhe të bashkëpunëtorit të Universitetit të Tetovës (nr. 01-4309/2, datë 01.12.2021). Interesi dhe aftësitë cilësore në fushën ku aplikon lejoi që kandidatja me **353.457** pikë të grumbulluara të tejkalon ndjeshëm numrin minimal të pikëve të kërkuara. Këto arritje dëshmojnë se kandidatja i plotëson të gjitha kushtet që të zgjidhet në thirrjen **profesor inordinar** në fushën mësimore shkencore *Metodikë* (5.03.00.03) dhe *Didaktikë* (5.03.00.02).

Sipas asaj që u tha më lartë, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë që ti propozojë Këshillit mësimor – shkencor të Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës, që doc.dr. Arbresha Zenki-Dalipi të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore **profesor inordinar** në fushat shkencore: *Metodikë* (5.03.00.03) dhe *Didaktikë* (5.03.00.02).

Komisioni recensues:

1. Prof.dr.Avzi Mustafa (kryetar) - profesor ordinar në pension  
\_\_\_\_\_
2. Prof.dr.Lulzim Mehmedi (anëtar) –profesor inordinar në Fakultetin Pedagogjik të UT  
\_\_\_\_\_
3. Prof.dr.Svetlana Pandiloska-Gërçaroska (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin Pedagogjik të UT  
\_\_\_\_\_

## FORMULARI 1

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMORË- PROFESIONAL DHE BASHKËPUNËTORË

**Kandidati:** Arbresha Meli Zenki-Dalipi

**Institucioni:** Fakulteti Pedagogjik – UT, Tetovë

**Fusha shkencore:** *Metodikë* (5.03.00.03) dhe *Didaktikë* (5.03.00.02).

### KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TUTULL MËSIMOR- SHKENCOR – PROFESOR I ASOCIUAR/ TITULL SHKENCOR – BASHKËPUNËTOR I LARTË SHKENCOR

Nr. Rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme/jo
1.	Suksesi mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, për secilin cikël veçmas, përkatësisht ka arritur sukses mesatar së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara në ciklin e parë dhe të dytë  Suksesi mesatar në ciklin e parë është: 8.48 Suksesi mesatar në ciklin e dytë është: 9.13 Suksesi mesatar për studimet e integruara /	Po
2.	Titulli shkencor – Doktor i shkencave të pedagogjisë Fusha shkencore: Edukim dhe Arsim Sfera shkencore: Metodika (5.03.00.03) dhe Didaktika (5.03.00.02)	Po
3.	Të publikuara së paku pesë punime shkencore të recensuara në publikime shkencore referente në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë në pesë vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhje	Po
3.1.	Revista shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensionit dhe e cila është e indeksuar në së paku një bazë elektronike të revistave me punime të qasshme në internet, siç janë: Ebsco, Emerald, Scopus, Web of Science, Journal Citation Report, SCImago Journal Rank ose bazë tjetër e revistave të cilën do ta përcaktojë Këshilli kombëtar për arsimin e lartë:	Po

Nr. Rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme/jo
	<p>1. Emri i revistës shkencore: <i>Knowledge International Journal</i></p> <p>2. Emri i bazës elektronike të revistës: EBSCO dhe IndexCopernicus.</p> <p>3. Titulli i punimit shkencor: Inclusion of contemporary reading comprehension approaches into the first cycle developmental curriculum</p> <p>4. Viti i publikimit: 2021</p> <p>-----</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <i>Knowledge International Journal</i></p> <p>2. Emri i bazës elektronike të revistës: EBSCO dhe IndexCopernicus.</p> <p>3. Titulli i punimit shkencor: The positive influence of images and graphics presentations in teaching texts for keeping students' attention and concentration</p> <p>4. Viti i publikimit: 2022</p> <p>-----</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <i>Knowledge International Journal</i></p> <p>2. Emri i bazës elektronike të revistës: EBSCO dhe IndexCopernicus.</p> <p>3. Titulli i punimit shkencor: Impact of communication difficulties on students' success</p> <p>4. Viti i publikimit: 2022</p> <p>-----</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <i>Dinamika Ilmu</i></p> <p>2. Emri i bazës elektronike të revistës: DOAJ, CrossRef.</p> <p>3. An Investigation into Teachers' Attitudes to Religious Education in North Macedonia Primary Schools</p> <p>4. Viti i publikimit: 2023</p> <p>-----</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <i>Journal of Positive Psychology and Wellbeing</i></p> <p>2. Emri i bazës elektronike të revistës: EBSCO, Google Scholar, PKP Index, ASOS, Turkish Medline, Arastirmax, Ulrich's, Citefactor, ERIH PLUS, Index Copernicus</p> <p>3. Exploring Intercultural Communication Competence Among Primary School Teachers In North Macedonia: A Survey Analysis</p>	

Nr. Rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme/jo
	<p>4.Viti i publikimit:2024</p> <p>-----</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: <i>Dinamika Ilmu</i>  2.Emri i bazës elektronike të revistës: DOAJ, CrossRef.  3. Intercultural Learning: Teachers’ Perspectives on the Influence of Intercultural Education on Students’ Competence  4.Viti i publikimit:2024</p>	
3.2.	<p>Revistë shkencore në të cilën punimet që publikohen u nënshtrohen recensimit dhe e cila ka këshill redaktues ndërkombëtar në të cilin bëjnë pjesë anëtarë nga së paku tre shtete,me atë që, numri i anëtarëve nga një shtet nuk mund t’i tejkalojë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: International Journal KNOWLEDGE  2. Këshill redaktues ndërkombëtar Numri i përgjithshëm i anëtarëve: 127 Numri i përkatësisë sipas vendeve: Republika e Maqedonisë Veriore (32) ,Bosnje dhe Hercegovina (11), Rusia (2), SHBA (2), Kosova (9), Anglia (1), Bullgaria (31), Serbia (20), Kroacia (2), Rumania (1), Austria (2), Sllovenia (2), Mali i Zi (3), Bahrejni(2), Polonia (1), Shqipëria (1), Bjellorusia (1), India (1), Italia (1), Ukraina (1), Filipine (1)  3. Titulli i punimit: Inclusion of contemporary reading comprehension approaches into the first cycle developmental curriculum  4.Viti i publikimit: 2021</p> <p>-----</p> <p>1. Emri i revistës shkencore: Journal of Educational Technology and Instruction  2. Këshill redaktues ndërkombëtar Numri i përgjithshëm i anëtarëve: 36. Numri i përkatësisë sipas vendeve: Turqi (12), SHBA (4), Poloni (3), Brazil (2), Nigeri (2), Greqi (2), Bosnje dhe Hercegovina (2), Shqipëri (2), Tajlandë (1), Angli (1), Fiji (1), Tunizi (1), Indi (1), Katar (1), Irak (1)</p>	Po

Nr. Rendor	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Plotësimi i kushteve të përgjithshme/jo
	<p>3. Titulli i punimit: Teachers' Attitudes Towards Desirable Intercultural Competences Necessary for Working in Multicultural Classrooms</p> <p>4.Viti i publikimit: 2023</p>	
